



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 06.02.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 02.02.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Krasniqi SHPK" për aktivitetin: "Pastrimi i objekteve të shkollave fillore "Gjergj Fishta", "Ismajl Qemali", "Asim Vokshi", "Naim Frashëri", "Pjetër Bogdani", "Shkolla e Gjelbërt" dhe PNF në Kolevicë" dhe me numër të prokurimit: 616 -17-3000-211 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Krasniqi SHPK" e datës 02.02.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit " Pastrimi i objekteve të shkollave fillore "Gjergj Fishta", "Ismajl Qemali", "Asim Vokshi", "Naim Frashëri", "Pjetër Bogdani", "Shkolla e Gjelbërt" dhe PNF në Kolevicë", me Nr.616 17 3000 211 Nr. Brendshëm _616 17 081 521 kundër *Njoftimit për anulim të aktivitetit* të AK –së, të datës 31.01.2018, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vërtetohet vendimi i AK për anulimin e aktivitetit të publikuar me datë: 31.01.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anuloj aktivitetin.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Krasniqi SHPK" me datë 02.02.2018 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Pastrimi i objekteve të shkollave fillore "Gjergj Fishta", "Ismajl Qemali", "Asim Vokshi", "Naim Frashëri", "Pjetër Bogdani", "Shkolla e Gjelbërt" dhe PNF në Kolevicë" me Nr. të Prok: 616 17 300 211; me Nr. të brendshëm të prokurimit: 616 17 081 521.

Autoriteti Kontraktues, me datë 06.02.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

1. Lidhur me pretendimet se se nuk janë plotësuar kushtet për trajtimin e tenderit si jo normalisht të ulët ju sqarojmë se e njëjta situatë ka qenë edhe me rastin e rivlerësimit të tenderit të OE-ik "MSS" dhe trajtimi i tillë është bërë në bazë të Vendimit të OSHP-se dhe në bazë të drejtës së Autoritetit Kontraktues për të vlerësuar nevojën eventuale të trajtimit të tenderit të secilit OE-ik në bazë të pikës 3.2 të Rregullores B 57. Lidhur me pretendimin se kjo mund të zbatohet vetëm kur ka çmime manipuluese i sqarojmë se edhe kjo bazë ekziston për arsyet që i paraqesim në vazhdim:

-Sipas dispozitave ligjore që e rregullojnë kontributin pensional dhe tatimin në paga në pagën bruto përfshihen të gjitha të ardhurat e përcaktuara në nenin 9.1.1 dhe 9.1.3 të Ligjit NR.05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale dhe nenin 6.1, 6.2, 6.3, 6.4, dhe 6.5 të Ligjit NR.04/L-101 Për Fondet pensionale të Kosovës dhe nenet 10-14 të Udhëzimit Administrativ MF-Nr.01/2016 e që që d.t.th. edhe përvoja e punës duhet të jetë e përfshirë në pagën bruto;

-Sipas dispozitave të njëjta janë të rregulluara përjashtimet e përfshirjes në pagën bruto (Neni 9.1.2 i Ligjit NR.05/L-028 dhe neni 11 i Udhëzimit Administrativ MF-NR.01/2016 është e përcaktuar qartë se nuk përjashtohet përvoja e punës siqë e pretendoni ju.

Bazuar në këto arsye të ligjore mund ta kuptoj secilin e edhe ju se kalkulimi juaj në kërkesën për rishqyrtim është në kundërshtim me ato dispozita dhe me qëllim të manipuluar, ndërsa kalkulimi që e keni pranuar në Njoftimin e Autoritetit Kontraktues është në harmoni të plotë me të njëjtat dhe i njëjti e argumenton se çmimi i tenderit tuaj është çmim jo normalisht i ulët, pasi që nuk mbulon pagat dhe detyrimet tjera financiare që nderlidhen me të njëjtat.

2. Pretendimet tjera nuk janë për komentime profesionale, por vetëm duhet sqaruar se që nga fillimi i procesit të ankesave, Autoriteti Kontraktues ka respektuar çdo Vendim të OSHP-se dhe rivlerësimet janë kryer në harmoni me të njëjtat. Siqë e dini me Vendimin e parë OSHP-ja ka konstatuar se çmimi i OE-ik të propozuar për dhenje të kontratës ishte jo normalisht i ulët për faktin se çmimi nuk është kalkuluar në harmoni me dispozitatat ligjore dhe se veprimi i njëjti është bërë edhe me rastin e trajtimit të tenderit tuaj.


3. Lidhur me deshmite e pagesave të pagave nga OE-ik tjetër "MSS" për vitin 2016, ju sqarojmë se të gjitha veprimet tona në rastin konkret kanë të bëjnë me aktivitetin për të cilin keni paraqitur kërkesën për rishqyrtim e jo për aktivitetet e kaluara dhe sa i përket këtij aktiviteti në jemi pajtuar me Vendimin e OSHP-se për kalkulim jo të saktë nga i njëjti dhe për këtë tenderi i të njëjtit është refuzuar, ndërsa mënyra e sigurimit të atyre deshmive është çështje me të cilat në të ardhmen duhet të merren organet tjera, pasi që të na nuk ka asnjë evidence zyrtare se ju ato deshmie i keni kërkuar nëpërmes rrugëve të ligjshme.

4. Lidhur me pretendimet tuaja për vlerësimet tona subjektive dhe me paragjykime dhe për zhvillim të procedurave të paligjshme, nuk ia vlen të merremi me to, pasi që janë organet kompetente që do ta thënë vlerësimin meritues lidhur me të njëjtat.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në sqarimet dhe konstatimet e paraqitura më lartë ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit